



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Construmax” Sh.P.K. të datës 18.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i therrtores publike” me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Construmax” Sh.P.K. e datës 18.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i therrtores publike” me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik “Construmax” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Construmax” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 18.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i therrtores publike” me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parë: “Te dëshmia dokumentare që OE duhet të ofroj një deklaratë të vulosur dhe nënshkruar për garancionin nga prodhuesi min. 1 vit, e nuk është askund e potencuar që duhet nga prodhuesi”.

Pretendimi i dytë: “kompania jonë ka dorëzuar planin dinamik të detajuar për secilin pozicion sipas formularit standard të bashkangjitur në e-prokurim tek DT, po ashtu në fund të rreshtave të planit dinamik kemi evidentuar që programi për punë do të dorëzohet për azhurnim brenda 15 ditëve në përputhje me dosjen e tenderit në kordinim me menaxherin e projektit”.

Pretendimi i tretë: “Ju si AK me eliminimin e kompanisë tonë pa kërkuar sqarime shtesë sic keni kërkuar për të njëjtat ISO nga ofertuesit e tjerë, përpos që nuk keni respektuar nenin 72 të LPP, nenin 10 të UPP dhe 38 të RRPP, ju keni bërë edhe diskriminin e kompanisë tonë dhe nuk keni trajtuar barabartë me OE tjerë”.

Pretendimi i katërt: “Potencimet lidhur me arsyet eliminuese janë dhënë për pika të cilat nuk kanë qenë kërkesa në DT”.

Pretendimi i pestë: “Arsyeja eliminuese autorizimi nuk është dhënë as nga prodhuesi dhe as nga distributori i autorizuar (është dhënë nga service provider) nuk është i qëndrueshëm pasi që në rast të paqartësive keni mundur të kërkonit sqarime shtesë”.

Pretendimi i gjashtë: “Arsyeja e potencuar që certifikata Eurovent është e skaduar është e pabazuar pasi që në DT nuk është kërkuar me pas validitet”.

Pretendimi i shtatë: “Arsyeja që në autorizimin e prodhuesit (distributorit) nuk është cekur titulli i projektit, numri i prokurimit si dhe nuk ka datë të autorizimit është i pabazuar për arsye se në DT nuk është cekur që duhet të jetë në emër të projektit apo data dhe ne si kompani kemi autorizim për ato produkte për furnizim dhe përdorim të përhershëm pasi që furnizohemi edhe për projekte tjera dhe nuk ka qenë e specifikuar që ky autorizim duhet të jetë në emër të projektit apo datës. Si do që të jetë për të dëshmuar që kjo arsye eliminuese është e paqëndrueshme dhe e parëndësishme, ne po ju bashkangjesim deklaratën e distributorit që ky autorizim vlen edhe për këtë projekt”.

Pretendimi i tetë: “Arsyetimi eliminues për gypat për ujësjellës pozicioni në BoQ 17.8-17.10 – autorizimi nga distributori nuk ka datë të lëshimit, është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar për arsye se në DT nuk është e precizuar që duhet të ketë datë autorizimi”.

Pretendimi i nëntë: “Arsyetimi eliminues njësitë për friza – pozicioni në BoQ 28.1-28.12, ISO 9001, ISO 14001, ISO 22001, ISO 45001 janë të skaduara afatet, është i paqëndrueshëm për arsye se përpos që nuk janë kërkuar me validitet në DT, po ashtu kemi dorëzuar dokumente të dy prodhuesve ku njëri nga prodhuesit i ka këto ISO me validitet”.

Pretendimet tjera ankimore i referohen tenderuesve të tjerë ku parashtruesi pajtohet me konstatimin e komisionit vlerësues që ata janë tenderues të papërgjegjshëm.

Lidhur me pretendimet ankimore duhet sqaruar se arsyet për eliminimin e parashtruesit janë evidentuar nga komisioni vlerësues si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

- Është kërkuar garancioni minimum 1 vit nga prodhuesi për pozicionet sipas pikës 6, mirëpo OE e ka dorëzuar deklaratën e nënshkruar nga vet si operatorë, andaj i njëjti kusht nuk plotësohet.
- Plani dinamik nuk e plotëson kriterin e paraqitur në dosjen e tenderit për vitin 2023,2024 dhe 2025, shih me poshte:

Vlera e parashikuar	2.4	3,500,000.00
		Buxheti për Viti 2023 - 1.400.000,00
		Buxheti për Viti 2024 - 1.100.000,00
		Buxheti për Viti 2025 - 1.000.000,00

- OE Construmax ka paraqitur plan dinamik për 112 dite dhe nuk është e përcaktuar që ky plan dinamik të bartet për vitet tjera sipas parashikimit në nenin 2.4 të DT dhe nuk ka të specifikuar që plani dinamik mund të bartet në vitet tjera.
- Dyert e frigodhomave → pozicionet në BoQ 12.11-12.18 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë të skaduar afatet
- Dritaret → pozicioni në BoQ 12.1-12.10 → ISO 9001 e skaduar (01.04.2015) dhe certifikata vetëm në gjuhën polake
- VRF → pozicioni në BoQ 29.11-30.1 → ISO 9001 e skaduar, * autorizimi nuk është i dhënë as nga prodhuesi e as nga distributori i autorizuar (është i dhënë nga Service provider), * Certifikata e EUROVENT është e skaduar 31.07.2020, * Ne autorizimin e prodhuesit (distributorit) nuk është e cekur titulli projektit, numri prokurimit si dhe nuk ka datë të autorizimit.
- Gypat për ujësjellës → pozicioni në BoQ 17.8-17.10 → autorizimi nga distributori nuk ka datë të leshimit.
- Njesit për friza → pozicioni në BoQ 28.1-28.14 → ISO 9001+ ISO 14001+ ISO 22001+ ISO 45001 janë të skaduar afatet (01.06.2022)

Sa i përket pretendimit të parë, kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë deklarata e garancionit të nënshkruar dhe vëlosur nga prodhuesi. Këtë fakt e potencojnë edhe vet parashtruesi kur e citon kërkesën ku konfirmohet se garancioni është kërkuar nga prodhuesi. Shih kërkesën e cituar si në vijim.

6. Garancioni minimum 1 vit nga prodhuesi për pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 16.10, 16.12, 26.5, 29.1, 29.11, 19.15, 30.1.	6. OE-ik duhet të ofrojë një deklaratë të vëlosur dhe nënshkruar për Garancionin nga prodhuesi min. 1 vit për pozicionet e kërkuara .
--	---

Parashtruesi nuk e ka dorëzuar deklaratën e garancionit të prodhuesit por e ka dorëzuar të vëlosur dhe nënshkruar prej vet parashtruesit si operator ekonomik tenderues. Ky fakt nuk kontestohet as prej parashtruesit por vetëm thuhet se nuk është kërkuar garancioni nga prodhuesit. Prandaj nuk e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit të dytë parashtruesi nuk e kundërshton faktin se planin dinamik që e ka dorëzuar ka qenë vetëm për 112 ditë dhe nuk është përcaktuar që të bartet edhe për vitet 2024 dhe 2025. Njëkohësisht parashtruesi nuk e konteston as faktin se përmes nenit 2.4 të dosjes së tenderit është përcaktuar si vijon:

Vlera e parashikuar	2.4	3,500,000.00 Buxheti per Viti 2023 - 1.400.000,00 Buxheti per Viti 2024 – 1.100.000,00 Buxheti per Viti 2025 – 1.000.000,00
---------------------	-----	--

Pra faktet më sipër nuk janë kontestuese as për vet parashtruesi megjithatë ky i fundit pretendon se në fund të planit dinamik ka vendosur një përshkrim sipas të cilit ka marrë përsipër që do të azhurnoj planin dinamik në koordinim me menaxherin e projektit. Fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk ka pasur fare të drejtë që të ndërhyjë në formularin e planit dinamik duke vendosur aty përshkrime përtej kërkesave të dosjes së tenderit të cilat nuk i ka lejuar formulari. Ndërsa sa i përket tekstit të përshkrimit, duhet cekur se plani dinamik ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit me qëllim që të shërbej për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderëve. Me fjalë të tjera, pas hapjes së ofertave nuk lejohet që të bëhet asnjë ndryshim material i ofertës (si psh ndryshimi i planit dinamik) pasi që kjo është e ndaluar me LPP. Për këto arsye pretendimi është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit të tretë dhe të pestë duhet cekur se sqarimet shtesë në kuptim nenit 72 janë përcaktuar si në vijim *“Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”*. Pra kjo dispozitë nuk e detyron autoritetin kontraktues që të kërkoj sqarime shtesë sa herë që tenderuesit i dorëzojnë gabimisht dokumentet apo nuk i përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit sikurse në rastin konkret. Pra kjo dispozitë shërben vetëm si mundësi (diskrecion i autoritetit kontraktues) për të plotësuar apo qartësuar dokumentet për të cilat mund të ekzistojnë paqartësi të caktuara. Në rastin konkret nuk ka pasur asnjë paqartësi dhe është e rikonfirmuar që parashtruesi nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Përkundrazi, nëse parashtruesi nuk i ka pasur të qarta kërkesat e dosjes së tenderit respektivisht nëse nuk i ka kuptuar ato, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë para hapjes së ofertave në mënyrë që të sigurohet se cilat dokumente duhet të bashkangjiten me ofertën e tij. Megjithatë parashtruesi nuk ka vepruar në këtë mënyrë prandaj oferta e tij ka mospërputhje të mëdha me dosjen e tenderit. Vlen të shtohet se po të kishte qenë në pyetje vetëm një dokument apo detal i vogël, atëherë do të ishte logjike të paraqiteshin edhe pretendime të tilla nga parashtruesi. Mirëpo kur marrim parasysh që mbi dhjetë mospërputhje të ofertës me dosjen e tenderit, nuk rezulton të ketë dilema se parashtruesi është i papërgjegjshëm. Përndryshe pretendimet ankimore janë në tërësi të pabazuara.

Sa i përket pretendimit të katërt të gjitha arsyet eliminuese janë saktësisht të bazuara në kërkesat e dosjes së tenderit prandaj pretendimi është absolutisht i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të gjashtë, të tetë dhe të nëntë, duhet sqaruar se të gjitha dokumentet e potencuara në këto pretendime respektivisht arsye eliminuese (çertifikata, autorizime, etj), janë dokumente të cilat lëshohen me afat të vlefshmërisë. Ndërsa parashtruesi i ka dorëzuar këto dokumente me afat të skaduar (që dmth ka dorëzuar dokumente të pavlefshme). Vlen të thuhet që parashtruesi ka pasur mundësinë të kërkoj sqarime shtesë para hapjes së ofertës për të evituar dilemën eventuale nëse dokumentet duhet të dorëzohen me afat të vlefshëm apo pa afat të vlefshëm. Një pyetje e tillë do të kishte qenë e ligjshme megjithëse krejt e palogjikshme sepse kuptohet që kur një dokument ka afat të validitet ai duhet të dorëzohet brenda atij afati dhe jo me afat të skaduar sepse atëherë ai dokument është i pavlefshëm. Megjithatë parashtruesi nuk e konteston faktin që ka dorëzuar dokumente të pavlefshme me afat të skaduar prandaj pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi. Sa i përket pretendimit të nëntë vlen të thuhet se parashtruesi pretendon se ka dorëzuar çertifikatat nga dy prodhues ashtu që çertifikatat e njërit prodhues janë me afat të vlefshëm. Megjithatë në mesin e dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi është gjetur se dokumentet në fjalë të gjitha janë me afat të skaduar që nënkupton se nuk janë përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit ndërsa tenderuesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për çka edhe është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Sa i përket pretendimit të shtatë ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar kopja e autorizimit të prodhuesit apo distributorit të autorizuar. Me këtë rast parashtruesi e ka dorëzuar një autorizim i cili nuk ka as datë kur është lëshuar dhe as për çka është lëshuar sepse nuk citohet as titulli i aktivitetit të prokurimit por as të paktën numri i aktivitetit të prokurimit. Në anën tjetër parashtruesi pretendon se në dosjen e tenderit nuk është kërkuar të dorëzohet autorizimi i prodhuesit për këtë aktivitet të prokurimit por vetëm një autorizim çfarëdo. Pra vet mënyra e formulimit të këtij pretendimi ankimor është e palogjikshme pasi që kur një operator ekonomik oferton për një aktivitet të prokurimit ku kërkohet autorizimi i prodhuesit, atëherë ai autorizim patjetër që i dedikohet aktivitetit të prokurimit ku është dorëzuar oferta. Sidoqoftë, parashtruesi nëse ka pasur dilemë se a duhet të dorëzohet autorizimi i prodhuesit për aktivitetin e prokurimit që ka ofertuar apo për ndonjë aktivitet tjetër të prokurimit, atëherë ka pasur mundësi që të kërkonte sqarime shtesë para hapjes së ofertave me ç' rast do t'i vihej në dispozicion edhe ky sqarim. Sidoqoftë, në këtë fazë nuk është kontestuese që parashtruesi ka dorëzuar një autorizim që nuk i referohet këtij aktiviteti të prokurimit (as titullit dhe as numrit) si dhe nuk ka fare datë të lëshimit, pasi që këtë fakt nuk e konteston as vet parashtruesi në pretendimin e tij. Vlen të thuhet se në kërkesën për rishqyrtim ka dorëzuar një autorizim tjetër të prodhuesit të datës 18.12.2023 mirëpo ky dokument nuk mund të merret parasysh jo vetëm për faktin që është dorëzuar në këtë formë (në kundërshtim me LPP dhe dosjen e tenderit) por mbi të gjitha është dorëzuar pas hapjes së ofertave si dhe i njëjti dokument mban datën 18.12.2023 që konfirmon se edhe dokumenti si i tillë është lëshuar dukshëm pas datës së hapjes së ofertave. Në të kundërtën do të manifeston një ndryshim material i konsiderueshëm në ofertën e parashtruesit i cili jo vetëm që është i kundërligjshëm por edhe po të ishte i ligjshëm sërish nuk e ndryshon epilogun e këtij vendimi për shkak të arsyeve tjera të eliminimit të parashtruesit si tenderues të papërgjegjshëm. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Sa i përket pretendimet të tjera ankimore të cilat ju referohen tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit, nga sa u tha më sipër është rikonfirmuar disa herë se arsyet e eliminimit të parashtruesit si tenderues të papërgjegjshëm janë arsye të sakta. Në anën tjetër të gjitha pretendimet ankimore pas shqyrtimit të secilës një nga një dhe të gjithave së bashku, është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi. Duke marrë parasysh këtë fakt, është rikonfirmuar se parashtruesi është tenderues i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Si i tillë, parashtruesi nuk mund të provoj asnjë interes material nga pretendimet e tij të cilat i drejton kundër tenderuesve të tjerë pasi që vet parashtruesi është i papërgjegjshëm. Rrjedhimisht parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me pretendimet e tij tjera ankimore kundër tenderuesve të tjerë.

Përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Nga ky kënd i vështrimit parashtruesi nuk mund të dëshmojë asnjë interes material nga pretendimet e tij kundër tenderuesve të tjerë përderisa vet parashtruesi është tenderues i papërgjegjshëm. Në anën tjetër përmes nenit 59 paragrafit 1 të RRPP është përcaktuar se *“kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar”*. Së këndejmi pretendimet e tjera të parashtruesit kundër tenderuesve të tjerë janë gjetur si të pabazuara apriori për shkak se parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me këto pretendime në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP lidhur me nenin 59 paragrafin 1 të RRPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara ndërsa parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht eliminimi i parashtruesit nga ky aktivitet i prokurimit sipas rekomandimeve të komisionit vlerësues është i saktë dhe i bazuar LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Vlen të shohet po ashtu se parashtruesi në këtë aktivitet të prokurimit përveç që ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për çka është eliminuar si tenderues, i njëjti ka dorëzuar edhe ofertë me çmim dukshëm më të lartë sesa tenderuesit e tjerë, ku çmimi është nënkriter i vlerësimit të tenderit ekonomikisht më të favorshëm me peshë të vlerësimit 60% (koeficient 0.6).

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.



Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.12.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.